



VENDIM PËR HEQJEN NGA LISTA E NJË ANKESE

Data e miratimit: 4 shkurt 2014

Numri i lëndës: 2012-23

Predrag Blagić

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 3 dhe 4 shkurt 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga:
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtar ligjor
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është parashtruar nga vëllai i ankuesit, Dragan Blagić-i. Ajo ishte regjistruar më 26 dhjetor 2012.

2. Më 1 gusht 2013, Sekretariati i Panelit i ka dërguar një letër z. Dragan Blagić-it, ku i ka kërkuar atij që ta siguronte një letër autorizimi, e cila e autorizon atë për të përfaqësuar vëllain e tij në procedurën pranë Panelit, si dhe dokumentet e tjera përkatëse për lëndën. Z. Blagić-i nuk ka arritur ta bënte këtë.
3. Më 9 janar 2013, Paneli edhe një herë ka kërkuar nga vëllai i ankuesit që të siguronte dokumentet e kërkuara dhe ka njoftuar atë se nëse nuk i përgjigjet letrës, Paneli mund të konsiderojnë se ankuesi nuk ka ndërmend ta ndjekë ankesën e tij dhe e heq atë nga lista e lëndëve.
4. Ankuesi dhe përfaqësuesi i tij nuk kanë arritur të përgjigjen ndaj kërkesave të Panelit dhe të kontaktojnë Panelin brenda afatit kohor të caktuar.

II. FAKTET

5. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga vëllai i ankuesit, mund të përmbliidhen si më poshtë:
6. Më 24 tetor 2012, ankuesi ka ardhur nga Serbia në kufirin administrativ në Jarinë. Ai pohon se ishte ndaluar nga policia kufitare e EULEX-it. Disa orë më vonë, ai pretendon se iu është dorëzuar Policisë së Kosovës dhe është transferuar në stacionin e policisë në Mitrovicën e jugut.
7. Edhe pas dy orësh, ankuesi është njoftuar se ishte akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Duke u mbështetur në vendimin e gjykatësit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut, ai ishte paraburgosur për tridhjetë ditë. Pas tetë ditësh në paraburgim ai ishte lirua me kusht.
8. Nuk është e qartë nëse tani për tani është në pritje ndonjë proces penal kundër ankuesit.

III. ANKESAT

9. Ankuesi pohon se ishte arrestuar në mënyrë të paligjshme dhe ishte paraburgosur; ai më tej pohon se arrestimi dhe paraburgimi i tij ishin të motivuara politikisht.

IV. LIGJI

10. Sipas rregullës 29 e *tutje*, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, Paneli mundet që në çdo fazë të procedurës të vendosë që ta heq ndonjë ankesë nga lista e lëndëve, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se ankuesi nuk ka qëllim që ta vazhdojë ankesën e tij/saj.

11. Pasi përfaqësues i ankuesit nuk iu është përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të Panelit për informacion, duket se ankuesi ka humbur interesimin për vazhdimin e ankesës së tij. Si rrjedhojë dhe në mungesë të një treguesi për ndonjë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut (shih rregullën 29 e *tutje*, paragrafin 2 të rregullores së punës), Paneli ka konstatuar se nuk arsyetohet vazhdimi i shqyrtimit të kësaj ankesë.

PËR KËTO ARSYE, Paneli njëzëri,

vendos që të heq këtë ankesë nga lista e lëndëve, në pajtim me rregullën 29 e *tutje* paragrafin 1 (a) të rregullores së punës.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese